

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Gjyqtari paguhet më shumë se Presidenti", juristi: E trishtë që drejtësia të bojkotohet vetëm për pagat – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/gjyqtari-paguhet-me-shume-se-presidenti-juristi-e-trishte-qe-d-rejtesia-te-bojkotohet-vetem-per-pagat/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 18:30:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 18:25:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c47de57559cb8caec754bf35432019c97b23c2bce19e19f8acd057e666c2a3a4
TEKSTI	3481929d6b353a0d0df2bad006a4fe41bb6056a22b220c58f61e60580fdd2fb1
PAMJA	f7a5da72930176eae4abfc1ba2e8f3749c916dca8abcef8e1b96e5bc04f96f3a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3d1c3205ccf0ac5d775dc21ca8d149503bc99eee7333fdeab86dd6a66f14ca6c
E MËPARSHMJA	21edd2206a99500c3491f836b9010b26dfdf0d9d850cf17fb527e06a7355aa2e
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3d1c3205ccf0ac5d775dc21ca8d149503bc99eee7333fdeab86dd6a66f14ca6c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Juristi Arbër Hoxha e konsideron të gabuar mënyrën se si po trajtohet çështja nga sistemi i drejtësisë.

Në një lidhje të drejtpërdrejtë në edicionin qendror të lajmeve në televizionin kombëtar Vizion Plus me moderator Roland Zlin, Hoxha argumenton se vendimet me karakter financiar duhet të kalojnë përmes Parlamentit dhe se KLGJ-ja dhe KLP-ja, duke vendosur për rritjen e pagave, kanë ndërhyrë në një kompetencë që i takon Kuvendit.

Sipas tij, edhe pse vendimi i Gjykatës Kushtetuese duhet të zbatohet, qeveria ka në dispozicion instrumente ligjore për ta adresuar situatën, përfshirë ndryshimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor.

Hoxha ngre gjithashtu shqetësimin për nivelin e pagave të magjistratëve në raport me profesionet e tjera, duke sjellë si shembull faktin se një gjyqtar i Gjykatës së Posaçme mund të paguhet rreth një herë e gjysmë më shumë se Presidenti i Republikës.

INTERVISTA E PLOTË:

Si qëndron sipas jush nga pikëpamja ligjore ky konflikt mes magjistratëve dhe qeverisë? Kush ka të drejtë

Arbër Hoxha: Ka dy qëndrime që janë: njëri është qëndrimi ligjor dhe tjetri është qëndrimi moral. Në vitin 2016, me ligjin për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor edhe të ashtuquajturën reformë në drejtësi, u besua që në qoftë se gjyqtarëve dhe prokurorëve do t'u rritej

5 Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor:
Një vit të mbarë për nxënësit,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

paga në mënyrë të konsiderueshme në raport me atë që e kishin, sigurisht që do të ishte një trend, le të themi edhe një impuls për të bërë sa më pak korrupsion. Por sigurisht që kjo e vendosi në mënyrë të shproporcionuar pagën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në nivelin e pagave të tjera të profesionistëve të këtij vendi, siç do të ishin mjekët apo edhe personat të tjerë të cilët kanë investuar pothuajse sa gjyqtarët, ndoshta edhe më shumë se gjyqtarët. Unë besoj që paga është një shpërblim i drejtë jo vetëm për punën që kryen një person, por edhe për investimin që ai ka kryer në jetë. Pra nëse do të krahasojmë pagën e gjyqtarëve me pagën e personave të tjerë të cilët punojnë jo vetëm në sistemin e drejtësisë por edhe më gjerë, pra me mësuesit, sigurisht që është shumë e shproporcionuar.

Po megjithatë jemi tani në momentin kur ata kanë paditur në SPAK ministrin e financave dhe pak ditë më parë KLGJ-ja dhe KLP-ja vendosën në mënyrë të njëanshme, le të themi t'i rrisin vetë pagat e tyre duke krijuar këtë problem. A përbën kjo një ndërhyrje në punën e parlamentit për shkak se vendimi në fund të ditës i takon parlamentit apo jo?

Arbër Hoxha: Sigurisht që po. Të gjitha aktet e karakterit financiar duhet të kalojnë nëpërmjet parlamentit. Ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese e cila shprehet në raport me pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe të gjitha të tjerat. Unë besoj që instrumenti që ka zgjedhur qeveria shqiptare për të luftuar këtë fenomen, pra të rritjes së pagës që aktualisht është më e madhe sesa e të gjithë profesionistëve të tjerë në Republikën e Shqipërisë, të mendosh që një gjyqtar i Gjykatës së Posaçme merr një herë e gjysmë më shumë se presidenti i republikës, kjo është e pamendueshme në një sistem demokratik në të cilin duam të bëjmë pjesë siç janë vendet e Bashkimit Europian. Por përtej kësaj, sigurisht që në qoftë se qeveria do të donte që të luftonte këtë fenomen dhe rritjen e pagave, mund ta bënte nëpërmjet ndryshimit të ligjit për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor, të cilit i ka numrat për hir të së vërtetës dhe mund e duhet që ta bënte. Në kushtet aktuale, nëpërmjet instrumenteve të caktuar i lind e drejta dhe detyra që t'i reflektojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Përse duhej një padi në SPAK dhe gjithë ky konflikt kur shumica e ka bërë të qartë publikisht që në datën 17 do rregullohet ligji dhe pagat kalojnë?

Arbër Hoxha: Për mua është shumë e trishtë që sistemi gjyqësor të shkojë në një grevë dhe bojkotim për dhënien e drejtësisë vetëm për pagat. Për mua do të ishte një lajm tepër pozitiv nëse gjyqtarët do të ngriheshin për të plotësuar vakancat në sistemin e drejtësisë dhe kjo po që do të përbënte lajm të mirë për qytetarët e Republikës së Shqipërisë, sepse mosplotësimi i vakancave në sistemin e drejtësisë ka sjellë një shtrirje shumë të madhe në kohë të marrjes së të drejtës. Qytetarët e Republikës së Shqipërisë presin më shumë se 20 vite që të marrin një vendim civil të formës së prerë dhe kjo pastaj e bën drejtësinë shumë të trishtë që gjyqtarët të ngrihen vetëm për pagat e tyre.

/vizionplus.tv

#Gjyqtarët

#paga

#VizionPlus



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

| Më shumë video



VIDEO

**Breshëria e plumbave
në Mat, kush ishte...**

**Xhuljana
Zhuleku**

Dje
14:17



VIDEO

**Mesazh me plumba
ndaj një gruaje?!...**

**Xhuljana
Zhuleku**

Dje
12:19



VIDEO

**Shpërthimi me tritol
në Shkodër, policia j...**

**Taulant
Halili**

Dje
00:27



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.